

EDUART CAKA

**NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KONTRIBUTIT
TË VAKËFEVE TE MEDRESETË NË SHQIPËRI
GJATË PERIU DHËS OSMANE**

Abstrakt:

Medresetë ishin institucionet më të larta arsimore në Perandorinë Osmane. Me gjithë ndryshimet që pësuan si në aspektin strukturor, ashtu edhe në atë arsimor e pedagogjik, medresetë e gëzuan këtë status deri në fundin e shek. XIX. Si pjesë e perandorisë, edhe në hapësirën shqiptare vërejmë një prezencë të këtyre institucioneve arsimore, të cilat i hasim kryesisht në qendrat e mëdha urbane siç qe Berati, Elbasani, Gjirokastra, Tirana, Shkodra etj. Në këtë artikull do të përpiqemi të nxjerrim një hartë të pranisë së medreseve në Shqipëri gjatë periudhës osmane, elementët dallues të tyre si dhe kontributin e vakëfeve në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e medreseve në këtë hapësirë përgjatë shekujve.

Fjalë kyçe:

Medresetë, vakëfet, Shqipëria, sundimi osman

Hyrje

Njëra prej fushave në të cilat vakëfet investuan më së shumti qe edhe ajo e arsimit. Ky kontribut lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe buronte nga rëndësia që besimi islam i jep të mësuarit.¹ Pikërisht kjo është edhe një nga arsyet kryesore që institucionet e bamirësisë, pra vakëfet, kanë ngritur shkolla, kanë financuar mirëmbajtjen e tyre, kanë sponsorizuar pagesat e mësuesve, por edhe kanë ngritur komplekse a ndërtesa të tjera që shërbenin si konvikte të cilat përdroreshin për strehimin e nxënësve të ardhur nga zonat e largëta për të mësuar në këto shkolla.

¹ Në literaturën fetare, por edhe në tekstet e vakfijeve të ndryshme, theksohet fakti se fjala e parë që ka zbritur nga Zoti ishte “Lexo” (Ikra). Pikërisht nga ky këndvështrim nisët edhe mendimi për të kërkuar dijen, për t’u shkolluar e për të ndërtuar edhe këto objekte ku merrej informacioni. Shih Mehmet İpşirli, *Osmanlı İlimyesi*, İstanbul: Kronik Kitap, 2021, f. 3-5.

Këtë qasje e vërejmë krejt qartë thuajse në të gjitha komplekset e bamirësisë që u ngritën fillimisht prej sulltanëve, vezirëve, pashallarëve të mëdhenj apo anëtarëve të dinastisë osmane ku, thuajse në pjesën më të madhe të vakëfeve që ata themeluan, vërehet se ata kanë ndërtuar institucione arsimore duke filluar qysh nga shkollat fillore e për të vijuar deri te medresetë. Njëri prej shembujve më ilustrues në këtë rast është edhe kompleksi prej tetë medreseve që u ngritën prej Mehmedit II në Stamboll. Në këto medrese zgjidheshin për të studiuar të gjithë ata fëmijë që kishin një nivel të lartë inteligjence dhe i gjithë arsimimi i tyre mbulohej prej vakëfit të sulltanit, i cili njëkohësisht ishte edhe mbikqyrësi i përgjithshëm i këtij institucioni.²

Nëse do të vijmë në hapësirën shqiptare, megjithëse e kemi të pamundur të datojmë shkollën më të hershme të hapur, ajo çka dimë me saktësi ka të bëjmë me faktin se ambiente të tilla ku mësohej shkrimi, leximi e feja u përhapën thuajse në të gjitha qytetet dhe fshatrat. Ky aspekt del qartë në pah prej shënimeve të shumta në lidhje me këto shkolla që gjenden nëpër fondet arkivore. Kështu, në saje të udhëtarëve të ndryshëm si Çelebiu, informacioneve të detajuara statistikore që jepen në salnametë e fundit të shek. XIX³ por edhe të burimeve arkivore, tanimë e kemi më të lehtë të paraqesim një tablo të shtrirjes së këtyre shkollave në hapësirën shqiptare si dhe kontributin që popullsia vendase përmes vakëfeve ka dhënë në ngritjen dhe mirëfunksionimin e tyre.

Në studimin e tij, Ayverdi ka mundur të evidentojë 111 mektepe në të gjithë hapësirën e Shqipërisë së sotme, pa përmendur këtu medresetë, të cilat do të trajtohen më poshtë. Më konkretisht, ai përmend 5 shkolla në Krujë e fshatra⁴, 6 të tilla në Vlorë e fshatra⁵, sërish 8 në Berat⁶, 29

² Halil İnalçık, *Devlet-i ‘Alîyye: Osmanlı İmparatorluğu Üzerine Araştırmalar*, C. I, İstanbul: Türkiye İş Bankası- Kültür Yayınları, 2016, f. 126-127.

³ Përveç anuarëve që botoheshin nëpër qendrat e vilajeteve, të cilat përmbajnë informacionet kryesore në këtë drejtim për hapësira të caktuara, kemi përdorur gjithashtu edhe salname të tjera që shtypeshin në Stamboll, të cilat kanë karakter të përgjithshëm dhe që nxirreshin nga ministritë e ndryshme, prej të cilave kemi mundur të përftojmë informacione interesante. Në rastin konkret, burimi që kemi përdorur për këtë pjesë të punimit, është anuari i publikuar prej Ministrisë së Arsimit (Maarif Nazareti) për vitin 1901. Për më shumë shih *1319 Yılı Maarif Nezareti Salnamesi*, tab. 4, Dar-u'l Hilafeti'l Alije 1319.

⁴ Më saktësisht, një shkollë fillore dhe katër të tjera të ciklit tetëvjeçar (rushdije), shih *İşkodra Vilayeti Salnamesi*, Tab. 3, Vilayet Matbaası, 1312, f. 96.

shkolla në Durrës dhe hapësirat përreth⁷, 18 në Gjirokastrë dhe fshatrat që vareshin prej saj⁸, 8 në Korçë, Elbasan dhe vendet e tjera që vareshin nga këto, 25 në Shkodër e rrethina⁹, 10 të tilla në Tepelenë dhe fshatrat që vareshin prej saj si dhe 2 mektepe të tjera, vendndodhja e të cilave nuk është identifikuar.¹⁰ Numri i dhënë nga Ayverdi në rastin e shkollave nuk është i plotë pasi në salnamenë e Shkodrës për qytetin e Tiranës përmendet një shkollë fillore dhe njëzet e pesë të tjera të ciklit të mesëm.¹¹ Ndërsa në Kavajë gjendeshin në total 11 shkolla të nivelit të ulët dhe një medrese.¹² Ndër qytetet e papërmendura prej Ayverdi-t është edhe Lezha ku, sipas të dhënave të anuarit të Shkodrës kishte dy mektepe.¹³

Sigurisht që, kur flitet për arsimin e shkollat nuk bëhet fjalë për një sistem laik edukimi të cilin jemi mësuar ta shohim sot. Në këtë kohë arsimi ishte kryesisht me karakter fetar dhe, vetëm në medresetë më të zhvilluara kryhej mësimi i disiplinave të ndryshme shkencore. Në nivelin e ulët, arsimi ishte totalisht fetar sikurse vetë shkollat apo ambientet ku

⁵ Çelebiu, në shek. XVII përmend ekzistencën e pesë shkollave fillore në Vlorë. Shih Evliya Çelebi, *Seyahatname*, C. 6, Akdam Matbaası, İstanbul: 1318, f. 706.

⁶ Çelebiu, të cilit i referohet edhe Ayverdi në studimin e tij, nuk e përmend numrin e saktë të mektepeve që kishte qyteti i Beratit gjatë kohës kur ai është gjendur këtu por, mjaftohet duke dhënë emrat e shkollave më në zë, të cilat qenë ato të Sulltan Bajezidit, Uzgurlusë, Murat Çelebiut dhe ajo e Teqesë. Për më shumë të dhëna shih Evliya Çelebi, *Seyahatname*, C. 8, Akdam Matbaası, İstanbul: 1318, f. 694.

⁷ Në salnamenë e Shkodrës përmenden 3 shkolla të sistemit të ulët vetëm për qytetin e Durrësit. Për më shumë detaje shih *İşkodra Vilayeti Salnamesi...*, Tab. 3, f. 115. Ndërsa Çelebiu, qysh në shek. XVII numëronte tre shkolla fillore për qytetin e Kavajës. Shih E. Çelebi, *Seyahatname...*, C. 8, f. 712.

⁸ Gjatë kohës kur ka vizituar qytetin, Çelebiu ka arritur të evidentojë ekzistencën e pesë mektebeve në Gjirokastrë. Madje ai tregon edhe vendndodhjen e këtyre institucioneve arsimore ku, ajo më e madhja ndodhej ngjitur me xhaminë e Bajezidit në kala, tjetra në lagjen Palor si dhe një e tretë, e cila gjendej e pozicionuar në pjesën e çarshisë. Për më shumë shih E. Çelebi, *Seyahatname...*, C. 8, f. 677. Edhe salnameja e Janinës përmend ekzistencën e tri shkollave ibtidaije dhe një tjetre rushdije për qytetin e Gjirokastrës, të cilat kishin një numër nxënësish që varionte nga 79 deri në 106 të tillë. Shih *Yanya Vilayeti Salnamesi*, Tab 6, sene 1308, f. 155.

⁹ Ndërkohë që në salname përmenden 17 mektebe vetëm për Shkodrën. Shih *İşkodra Vilayeti Salnamesi...*, Tab. 3, f. 68.

¹⁰ Ekrem Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri*, I-IV, İstanbul: İstanbul Fetih Cemiyeti, 2000, f. 436.

¹¹ *İşkodra Vilayeti Salnamesi...*, Tab. 3, f. 124.

¹² *Po aty*, f. 130.

¹³ *Po aty*, f. 90.

kryhej aktiviteti edukativ. Ato gjendeshin në afërsi të xhamive ose brenda tyre¹⁴, mësuesit ishin klerikë por edhe vakëfet që sponsorizonin aktivitete të ngjashme të mësimdhënies, themeloheshin me qëllimin e mësimi “të besimit të Zotit”. Madje, një pjesë e hoxhallarëve që jepnin mësim në këto shkolla nuk e njihnin sipas rregullave gramatikore as vetë osmanishten, por mjaftoheshin duke u mësuar fëmijëve leximin e Kur’anit si dhe të njohurive elementare të besimit. Siç duket, deri nga shek. XIX pjesa më e madhe e vakëfeve të xhamive merrnin përsipër pagesën e këtyre hoxhallarëve, si detyrën e imamit ashtu edhe për rolin e mësuesit që kryenin, ndërsa në vitet e fundit të perandorisë vetë prindërit e kryenin këtë pagesë.¹⁵

Edhe aspekti i kurrikulave dhe periudhës kohore të arsimimit nuk duhet matur me parametrat dhe metodat bashkëkohore të sistemit. Megjithëse shkollat, të cilat qenë anekse të xhamive dhe kishave, i gjejmë të përhapura në një pjesë të madhe të qyteteve e fshatrave, ky proces konsistonte kryesisht vetëm në mësimin e alfabetit dhe të disa lutjeve kryesore fetare. Në fillimet e shek. XX, Eqrem Bej Vlora e përshkruante me këto fjalë kohëzgjatjen e këtyre mësimëve dhe lëndët që mësoheshin në këto shkolla, të cilat qenë kryesisht të ciklit fillor¹⁶:

“Ndër qytete e lajnë shkollën pas shtat vjet mësimi, sidomos ata nxënësish më të zgjuet. Mësimet e tyre përbahen vetëm nga bazat elementare të gjuhës turqishte; për këtë numronen ndër ma të dijsmit dhe e shtojnë pra gjendjen e nderueme të lutje-shruesve (arzuhalxhi); këta janë shkruet që e kalojnë jetën me përpilimin e lutjeve e të shkresave të tjera.”

¹⁴ Për shembull, në rastin e Beratit, Çelebiu flet se në këtë qytet kishte një numër të madh nxënësish dhe në të gjitha xhamitë gjendeshin mësues, të cilët jepnin mësim në mënyrë të vazhdueshme. Shih E. Çelebi, *Seyahatname...*, C. 8, f. 694.

¹⁵ Në lidhje me pagesën e mësuesve të këtyre shkollave, na tërheqin vëmendjen dëshmi që ka mundur të mbledhë A. Çausi në Elbasan ku shprehet se: “*nxansit i paguanin mësuesit çdo hanë (muaj) një pular, monedhë bakri, që vlente 5 metalikë dhe disa të tjerë me gjendje ekonomike më të mirë dhe në mësim më të ngritura paguajshin nga një tresh që do të thoshte tre grosh.... Nxansi që kryente fund e krye leximin e Kuranit, veç pagës së përmuejshme do t’i çonte mësuesit bohçelik që don të thotë dhuratë e cila përmante këmishë e brekë të linta, një abdest peshqir dhe një mexhide, monedhë argjendi me vlerën e 1/5 të lirës turke të atëhershme, se do të zbriste hatme.*” Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH), E-I-17, Abedin Çausi, “Esnafët në Elbasan”, f. 9.

¹⁶ *Po aty*, A-III-160, Eqrem Vlora, “Nga hani i Jagobinës për në Berat”, f. 27-28.

Sigurisht që kurrikula e shkollave ndryshonte nga vendi ku gjendej shkolla. Kështu, nëse në mektepet e fshatrave mësoheshin gjërat bazike të cilat i përshkruan Vlora, më ndryshe ishte situata në qendrat e zhvilluara urbane ku mësimet jepeshin më të plota. Me kalimin e kohës, edhe numri i lëndëve është shtuar duke e pasuruar kurrikulën arsimore. Kështu, në fundin e viteve 1880, në shkollën ruzhdije të Shkodrës, e cila është ekuivalente me arsimin e nivelit tetëvjeçar të periudhës së mëvonshme, mësojmë të jenë dhënë këto lëndë: besim, arabisht, persisht, turqisht, aritmetikë, gjeometri, histori, diktim, kontabilitet, vizatim, thuluth, divani, rika.¹⁷

Një panoramë krejt të ndryshme nga ajo që u parashtrua më sipër paraqiste edukimi i fëmijëve të familjeve të pasura, veçanërisht gjatë shek. XIX. Në kuadër të modernizimit, vetë shteti osman do të hapte shkolla të profesionalizuara, ku ndër më kryesoret ishin kolegjet ushtarake por, gjithashtu do të dërgonte persona të zgjedhur nëpër shkollat më të famshme të Evropës. Parë nga ky këndvështrim, fëmijët e pashallarëve apo të parisë së hapësirave rurale, qysh në fëmijërinë e tyre merrnin një përgatitje mësimore më të privilegjuar nga moshatarët e tyre, me qëllim që ta vijonin arsimimin në shkollat e sipërpërmendura dhe të fillonin karrierën si funksionarë të lartë. Më saktësisht, këta fëmijë merrnin mësim private në shtëpi ku, në një pjesë të mirë të rasteve, mësuesit e tyre qenë perëndimorë. Një përshkrim të hollësishëm të këtij arsimimi, të lëndëve që mësonin por edhe të orarit mësimor na e jep Eqrem Bej Vlora. Ai shprehet se si fëmijët e familjes së vet por edhe kushërinjtë e tij, i merrnin mësimet e gjuhëve të huaja prej profesorëve të ndryshëm që kishin ardhur nga Evropa, se procesi mësimor zhvillohej në ambientet shtëpiake, se gjithçka kryhej sipas rregullit e programit dhe se krahas gjuhëve të huaja dhe lëndëve kryesore, ata mësonin edhe kalërim, pikturë, piano etj.¹⁸

¹⁷ Për më shumë shih Hamdi Bushati, *Shkodra dhe Motet*, vëll. II, Shkodër: Rozafat, 1998, f. 36.

¹⁸ Në rastin konkret, përveç lëndëve të ndryshme mësimore, mësojmë se fëmijët e familjes Vlora i merrnin mësimet e frëngjishtes dhe gjermanishtes nga profesor Feigenwinter që kishte ardhur nga Zvicra, arabishten, persishten e turqishten prej Jusuf Riza Efendiut nga Stambolli si dhe italishten nga don Luigi. Vetëm njohuria e këtyre gjashtë gjuhëve dhe fakti se ata i merrnin këto mësimet prej personave më të kualifikuar, është një tregues i qartë i arsimit cilësor që merrnin fëmijët e familjeve të pasura apo të parisë së vendit. Shih Eqrem Bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, përkthyer nga Afrim Koçi, Tiranë: Botimet IDK, 2010, f. 41.

Medresetë në Perandorinë Osmane

Ndryshe nga shkollat fillore të cilat qenë të përhapura gjerësisht dhe jepnin mësim elementare të shkrim-këndimit dhe të besimit, medresetë qenë institucione të mirëfillta arsimit, madje kulmi i sistemit arsimor osman, ku nxënësit merrnin në mënyrë profesionale dhe të thelluar edukim në disa fusha. Këtu nuk mësoheshin vetëm lëndët fetare por edhe ato të shkencave të ndryshme si filozofia, logjika, gramatika, letërsia, matematika, astronomia, mjekësia etj., si dhe në fusha të tjera të artit siç qe muzika e kaligrafia. Në këto medrese jepnin mësim dijetarë të shquar osmanë por edhe të tjerë që vinin nga hapësira të ndryshme brenda dhe jashtë perandorisë.¹⁹

Sigurisht që medreseja nuk u shpik nga osmanët, por qe një institucion i rëndësishëm që ishte përhapur përgjatë shekujsh në të gjithë botën islame. Në kontekstin institucional, studiuesit bashkohen në mendimin se për herë të parë në historinë islame, medreseja u ngrit si një institucion i mirëfilltë arsimor prej Nizamulmulkut, njëri prej vezirëve më të njohur të Shtetit të Madh Selçuk.²⁰ Ndërsa tek osmanët, këto institucione do të pësonin zhvillime të tjera që lidheshin me arritjet e dijes dhe teknologjisë. Kështu, midis medresesë së parë të osmanëve që u hap në Iznik prej Orhan Gazit në vitin 1331²¹ dhe asaj që ngriti Sulltan Mehmedi II pas një shekulli, kishte ndryshim të madh si në aspektin arkitekturor ashtu edhe në atë pedagogjik e shkencor.²² Megjithatë, në

¹⁹ Për disa prej dijetarëve të mëdhenj të kohës, por edhe lëndëve që mësoheshin në medresetë e mëdha shih Mehmet İpşirli, “Medrese: Osmanlı Dönemi”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, c. XXVIII, TDV Yay., Ankara: 2003, f. 328. Ndërsa për lëndët që mësoheshin në këto medrese si dhe librat të cilat qenë në kurrikulën e këtyre institucioneve, shih Bilgin Aydın, İsmail Erünsal, “Tereke Kayıtlarına Göre Osmanlı Medrese Talebelerinin Okuduğu Kitaplar (XVII-XX Yüzyıllar)”, *Osmanlı Kültür Tarihinin Bilinmeyenleri: Şahıslardan Eserlere, Kurumlardan Kimliklere*, ed. Filiz Dıġırođlu, Zeynep Berktaş, Timaş Yay., İstanbul: 2014, f. 173-204.

²⁰ Bëhet fjalë për medresenë “Nizamije” e cila duket se e ka marrë emrin nga veziri në fjalë. Shih M. İpşirli, *Osmanlı İlimiyesi...*, f. 321.

²¹ M. İpşirli, “Medrese: Osmanlı Dönemi ...”, f. 327.

²² Mehmedi II ngriti një kompleks të madh në qendër të qytetit të Stambollit, pjesë e të cilit qe edhe medreseja Sahn-i Seman që ishte edhe kulmi i dijes në shtetin osman ku jepnin mësim dijetarët më të mëdhenj të kohës dhe përveç lëndëve fetare, mësohej edhe logjika, filozofia, kimia, matematika, astronomia e degë të tjera. Më saktësisht, këto qenë tetë medrese të pozicionuara në të dyja anët e xhamisë së Mehmedit II dhe

aspektin e elementëve bazë të funksionimit të medreseve, e cila konsistonte në praninë e një myderrizi (profesor) ose më shumë, në rastin e atyre të mëdha, si dhe të faktit që frekuentuesit e institucionit duhej të ishin nxënës myslimanë, duket se nuk ka pasur ndryshime.

Medresetë kryesisht financoheshin prej sulltanëve, anëtarëve të familjes perandorake, vezirëve a pashallarëve dhe qenë pjesë e komplekseve të mëdha të bamirësisë të financuara prej tyre. Këtë aspekt e vërejmë edhe te medresetë që u ngritën në hapësirën shqiptare, të cilat do t'i shohim më poshtë. Parë nga ky këndvështrim, nëse do të kemi parasysh faktin se komplekse të tilla ndërtoheshin nëpër qendra të mëdha urbane, edhe medresetë më të zhvilluara të perandorisë i hasim në qytetet e Stambollit, Edirnesë, Bursës, Damaskut, Bagdatit, Kajros, Selanikut etj.

Në një shtet me burokraci të theksuar, sigurisht që edhe medresetë nuk ishin institucione që ngriheshin prej një bamirësi e ku jepte mësim një apo disa mësues. Përkundrazi, këtu luanin rol të rëndësishëm faktorë të shumtë, të cilët fillonin qysh nga numri i mësuesve, lëndët që jepeshin, niveli i nxënësve si dhe pagesat dhe shpenzimet e tjera ku, institucioni arsimor që ndërtoi Mehmedi II e që njihej si Sahn-i Seman paraqiste edhe majën e arsimit në Perandorinë Osmane.²³

I madh që edhe numri i medreseve që u ndërtuan në hapësirën ballkanike ku, nga studimet e deritanishme është arritur të evidentohet ekzistenca e më shumë se 575 institucioneve të tilla.²⁴ Ndërsa në hapësirën gjeografike të Shqipërisë së sotme, numri i medreseve që jepet prej studiuesve është 28.²⁵ Pjesa dërrmuese e këtyre medreseve që

godinat e tyre qenë të mbuluara me plumb. Këtu përzgjidheshin nxënësit më të zgjuar dhe të gjitha shpenzimet përballoheshin prej vakëfit të Sulltan Mehmetit II. Në këtë institucion mësonin më shumë se 600 nxënës (softa). Uzunçarshili bën një shpjegim të detajuar të medresesë, mësuesve që jepnin mësim këtu si dhe lëndëve që iu jepeshin nxënësve. Zeki Pakalın, *Osmanlı Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü*, C. II, M. E. B. Yay., İstanbul: 1993, f. 437.

²³ Hierarkia e medreseve osmane për nga niveli e cilësia që ndarë në pesë kategori: *Sahn-i Seman, Dahil, Hariç, Kirkli, Miftah* dhe *Hashije-i texhrid*. Për më shumë të dhëna mbi kriteret e ndarjes dhe kategorizimin e tyre, shih Z. Pakalın, *Osmanlı Tarih Deyimleri...*, C. II, f. 438.

²⁴ M. İpşirli, "Medrese: Osmanlı Dönemi...", f. 328.

²⁵ Përkatësisht: 1 në Krujë, 3 në Vlorë, 3 në Berat, 3 në Durrës dhe fshatra, 7 në Gjirokastrë dhe fshatra, 6 në Korçë, Elbasan dhe fshatra, 2 në Shkodër, 2 në Tepelenë dhe një tjetër e cila nuk është evidentuar se ku gjendej. Për më shumë shih E. Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı...*, c. IV, f. 436. Për medresenë e Krujës mësojmë nga anuari i *Maarif Nezareti* ku shkruhet se institucioni në fjalë gjendej brenda qytetit, ishte

ndërtuar në qendrat e mëdha urbane por kishte edhe fshatra në të cilat haseshin institucione të tilla. Duke qenë institucione me një numër punonjësish të shumtë në numër, për mirëmbajtjen e medreseve nevojiteshin të ardhura të mëdha. Pikërisht kjo është edhe arsyeja që ato kryesisht u ngritën si pjesë e vakëfeve të mëdha dhe në qendra të zhvilluara urbane.

Mbi medresetë që u ngritën në Shqipëri gjatë periudhës osmane

Të dhëna mbi medresetë që funksiononin në hapësirën shqiptare hasim edhe në dokumentacionin arkivor, pjesë e cila do të kërkonte një studim më vete nëse do të kemi parasysh rëndësinë që kishin këto institucione arsimore. Megjithatë, ne do të mjaftohemi vetëm duke u ndalur në rolin e vakëfeve dhe kontributin që këto institucione të bamirësisë dhanë në funksionimin e mirëfilltë të proceseve arsimore në medresetë e qyteteve a fshatrave të ndryshme. Pra, këtu kemi për qëllim të parashtrijmë një panoramë të lidhjes që ekzistonte midis vakëfit e medresesë, jo që të paraqiten në mënyrë të detajuar këto institucione arsimore pasi siç u pa edhe nga një krahasim i të dhënave që jep Ayverdi me informacionet e burimeve të tjera historike, jo vetëm që shifrat e dhëna paraqesin mospërputhje por, edhe dokumentacioni arkivor në lidhje me këtë temë do ta kalonte objektivin e punimit tonë.

Pikësëpari duhet theksuar se nuk kishte procedura apo rregulla që përcaktonin numrin dhe specifikat e medreseve që hapeshin në një qendër urbane. Kjo, pasi këto institucione arsimore ngriheshin me kontributin e bamirësve, pra qenë nisma individuale. Megjithatë, aspekte si gjendja ekonomike, demografia e qytetit, kultura si dhe elementë të tjerë që kishin të bënin me veçoritë e qyteteve qenë faktorë të cilët ndikonin edhe në ngritjen e medreseve. Kështu, ato qytete që kishin një numër të madh banorësh ose qenë qendra administrative vërejmë që të kenë pasur një përqendrim më të madh të objekteve të ngjashme. Fjala vjen, në një qytet

ndërtuar prej Shemseddin Efendiut dhe se aty studionin 46 nxënës. Për më shumë detaje shih: *1319 Yılı Maarif Nezareti Salnamesi*, tab. 4, Dar-u'l Hilafeti'l Alije 1319, f. 352 (më tej cituar: *Maarif Salnamesi...*). Edhe salnameja e Janinës përdor shumësin për medresetë e Delvinës, aspekt i cili tregon se në këtë kaza kishte së paku dy të tilla. Për më shumë të dhëna shih *Yanya Vilayeti Salnamesi...*, Tab 6, f. 162.

si Manastiri, i cili për një kohë kishte shërbyer edhe si qendër vilajeti, aty nga fundi i shek. XIX numëroheshin plot nëntë medrese.²⁶

Një nga qytetet shqiptare, që varej nga vilajeti i Manastirit në gjysmën e dytë të shek. XIX, që edhe Korça, e cila në këtë kohë duket se ka patur një institucion të tillë arsimor, që në regjistrimet zyrtare përmendet si medreseja e Haxhi Ali Agait. Nga shënimet që hasim në anuarin osman të vitit 1901 rreth objektit në fjalë, mësojmë se ndërtuesi i këtij institucioni arsimor që personi i quajtur Ali Aga nga Shkupi dhe se këtu mësonin plot 71 nxënës.²⁷

Si qyteti më i madh për nga numri i popullsisë në Shqipërinë e Mesme, qyteti i Elbasanit nuk e reflektonte peshën e tij ekonomike e demografike në numrin e medreseve teksa vijmë në fundin e shek. XIX. Kështu, në anuarin osman të vitit 1901 në lidhje me institucionet arsimore, Elbasani i cili varej në aspektin administrativ prej Manastirit, vërejmë të ketë pasur funksionale vetëm një medrese. Objekti në fjalë ishte ndërtuar prej Haxhi Ibrahimit dhe në këtë institucion mësonin 32 nxënës.²⁸ Siç duket, kjo ishte medreseja e vetme në qytet pasi, ashtu sikurse e pamë edhe në informacionet që jep Ayverdi mbi institucionet e këtij niveli në Elbasan e rrethina (duke përfshirë një hapësirë gjeografike më të gjerë e cila zgjatej deri në Korçë), numëroheshin plot gjashtë institucione të tilla.

Nga 7 medrese që Ayverdi jep për Gjirokastrën, anuari i vilajetit të Janinës i vitit 1890-91 vetëm në qytet numëron dy të tilla. Në të vërtetë, megjithëse përmend ekzistencën e tri medreseve për këtë qytet, Çelebiu në gjysmën e dytë të shek. XVII përmend emrat e dy prej tyre, përkatësisht atë të Bajezid Hanit dhe të Memi Pashës.²⁹ Siç duket, pjesa tjetër e medreseve të qytetit dhe fshatrave përreth duhet të jenë ngritur gjatë shekujve të mëvonshëm. Kështu, njëra prej këtyre medreseve të Gjirokastrës që edhe ajo e Pazarit, e cila ishte ndërtuar prej Muhtar Agë Iskandolit, rreth të cilit nuk hasim ndonjë të dhënë tjetër. Bamirësi në fjalë duhet të jetë një person i shtresës së mesme, aspekt i cili evidentohet

²⁶ Për më shumë të dhëna në lidhje me medresetë e Manastirit shih Mehmed Tevfik, *Historia e vilajetit të Manastirit*, përkthyer nga Ahmet Sherif, Shkup: Logos-A, 2016, f. 50-51.

²⁷ Shih *Maarif Salnamesi...*, f. 893.

²⁸ Për detaje më të hollësishme në lidhje me medresenë në fjalë si dhe institucionet e tjera të këtij rangui për vilajetin e Manastirit shih *Maarif Salnamesi...*, f. 893.

²⁹ Shih E. Çelebi, *Seyahatname...*, C. 8, f. 677.

prej godinës së medresesë të sipërpërmendur, për të cilën Kiel shprehet se qe një ndërtim modest.³⁰

Më shumë se diskutimi mbi numrin e medreseve që kishte qyteti, shumë interesante janë edhe informacionet që salnameja në fjalë na jep në lidhje me mësimet që jepeshin në këto institucione arsimore. Kështu, përveç lëndëve fetare në kurrikul përfshiheshin edhe sarf (Morfologji), nahiv (Sintaksë), oratori e logjikë. Pra, në këto institucione arsimore mësoheshin edhe shkencat e gjuhësisë, komunikimit e filozofisë.³¹

Sigurisht që për të dhënë mësim në shkencat e fesë por edhe ato të gramatikës, oratorisë e filozofisë nevojitej që mësuesit të kishin një përgatitje të madhe. Prandaj, në medrese e cila konsiderohej edhe si niveli më i lartë i shkollës në sistemin klasik osman dhe atë islam, merreshin edhe myderrizët më të aftë e të spikatur. Në rastin konkret, në varrezat e xhamisë Mbret të Beratit gjendet edhe varri i myderriz Osman Efendiut, i cili kishte qenë mësues në njërën prej xhamive të qytetit dhe, sipas mbishkrimit del se ka ndërruar jetë në vitin 1259 H./ 1852-53. Buharaja i cili e ka evidentuar kronogramën në fjalë, duke iu referuar edhe traditës gojore, shprehet se aty prehej Osman Tahsin Çami, i ati i Hoxha Hasan Tahsinit, njëri prej personaliteteve kryesore të dijes dhe të shkencës në Perandorinë Osmane gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX.³²

Thuajse të njëjtën panoramë e hasim edhe në Vlorë, një qendër e rëndësishme administrative, strategjike dhe ekonomike e hapësirës shqiptare, e cila në shek. XIX gjendej administrativisht e varur prej vilajetit të Janinës. Qysh në shek. XVII Evlija Çelebiu ka gjetur tri medrese gjatë vizitës që ai ka kryer këtu, aspekt i cili tregon se këto institucione arsimore, së paku, datojnë në këtë shekull. Më konkretisht, kronikani osman përmend ekzistencën e medresesë së Jakup Efendiut, të Mumxhuzadesë si dhe atë të Hysen Agës.³³ Teksa vijmë në fundin e shek. XIX në këtë qytet vërejmë të ketë rënë numri i këtyre institucioneve arsimore. Më saktësisht, në anuarin e vitit 1901 për Vlorën shohim vetëm

³⁰ Machiel Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri 1385-1912*, përktheu Klodiana Smajlaj, Tiranë: AIITC, 2012, f. 180.

³¹ *Yanya Vilayeti Salnamesi...*, Tab 6, f. 156. Edhe në medresetë e Manastirit vërejmë të jenë dhënë lëndë si gjeometria apo astronomia. Shih M. Tevfik, *Historia e vilajetit të Manastirit...*, f. 51.

³² *AIH*, A-III-435, Vexhi Buharaja, “Mbishkrime të marra nga xhamitë në rrethet Krujë, Lezhë, Shkodër, Vlorë, Tiranë, Përmet etj.”, Tiranë: 1959, f. 1.

³³ E. Çelebi, *Seyahatname...*, C. 8, f. 706.

një medrese, e cila duket se qe ndërtuar prej Mustafa Pashë Vlorës dhe këtu studionin 35 nxënës.³⁴

Në këto qendra të mëdha urbane që përmendëm jetonin tregtarë, dijetarë e funksionarë të pasur, të cilët, jo vetëm që financonin ndërtimin e medreseve të mirëfillta duke ndarë shuma të mëdha parash për ndërtimin e tyre por, gjithashtu vërejmë të kenë sjellë si profesorë nëpër këto institucione arsimore klerikë e dijetarë të shquar të krahinave përreth ose të anëve të ndryshme të perandorisë. Kështu, profesorë të aftë nga Janina, Manastiri, Ohri, Prizreni e Peja apo treva të tjera por edhe të tjerë që vinin nga distanca më të largëta qenë angazhuar si mësimdhënës në këto medrese. Për shembull, në medresetë e Shkodrës mësojmë të kenë dhënë mësim dijetarë nga Krimeja apo edhe Egjipti.³⁵

Njëra prej medreseve të qytetit të Beratit, siç del në pah edhe nga dokumentet, ishte ajo e Mehmet Bej Bukëvalës. Objekti arsimor duket të jetë ndërtuar prej të njëjtit bamirës pranë xhamisë që mban emrin e tij. Kështu, në vitin 1702, një bamirës i quajtur Ali Hoxha deklaroi përpara kadiut se linte vakëf shumë të 66 000 akçeve, e cila do të shkonte në favor të xhamisë dhe medresesë së Mehmet Beut.³⁶ Dokumenti në fjalë është i rëndësishëm pasi Ayverdi, i cili gjithashtu i referohet edhe Çelebiut, flet për praninë e tri medreseve në qytet porse nuk i përmend emrat e tyre.³⁷ Në të vërtetë, Çelebiu flet edhe për pesë medrese në Berat duke dhënë vetëm emrat e dy të tillave, ndërsa për tre të tjerat nuk thotë asgjë. Dy medresetë e përmendura qenë ato të Sulltan Bajezidit dhe të Ugzurlusë.³⁸ Siç duket, Ayverdi i është referuar gabimisht Çelebiut duke cilësuar tri institucione të tilla për Berat, numër i cili, në fakt, lidhet me shifrën e medreseve për të cilat kronikani osman nuk na jep asnjë të dhënë.

Një medrese tjetër në Berat ishte edhe ajo pranë xhamisë Atik (Vjetër), ekzistencën e së cilës e parashtrua më sipër përmes një dokumenti ku personi i quajtur Sadi Efendi linte vakëf një shumë prej 80 mijë akçesh, parë të cilat do të përdreshin për mbulimin e shërbimeve të ndryshme të disa xhamive e shkollave të Beratit, në mesin e të cilave

³⁴ Shih *Maarif Salnamesi...*, f. 935.

³⁵ H. Bushati, *Shkodra dhe motet...*, vëll. II, f. 92-93.

³⁶ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 128, Dosja (më tej: D.) 21, fl. 59/A.

³⁷ E. Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı...*, c. IV, f. 408, 436.

³⁸ Për më shumë të dhëna shih E. Çelebi, *Seyahatname...*, C. 8, f. 694.

përmendet edhe medreseja në fjalë.³⁹ Në të njëjtin dokument, i cili ndodhet pranë Arkivit të Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve në Ankara, gjejmë informacionin se të dy bamirësit kishin ngritur edhe shkollën e leximit të Kur'anit krahas medresesë dhe se këto objekte pozicionoheshin brenda kompleksit të xhamisë së Hysen Pashës. Në dokumentin që mban datën 13 gusht 1679, krahas shumë prej 100 mijë akçeve përmenden edhe pagesat që do të marrin njerëzit e autorizuar me administrimin e këtij vakëfi.⁴⁰

Me medresenë e Uzgurit dhe ato të Mehmet Beut si dhe tjetrën në afërsi të xhamisë së Vjetër, plotësohet numri i tri medreseve që përmenden në burime për qytetin e Beratit. Mirëpo në fondet arkivore hasim dokumente të cilat flasin për praninë edhe të medreseve të tjera. I tillë është rasti i një objekti tjetër të ndërtuar përballë xhamisë së Hysen Pashës, e cila gjendej në lagjen Murat Çelebi në të njëjtin qytet. Ndërtuesit e saj janë zonja Aishe dhe i shoqi, Salih Beu, që të dy trashëgimtarë të familjeve me emër, aspekt i cili evidentohet nga titujt “Pasha” që kanë baballarët e të sipërpërmendurve. Një tregues tjetër i gjendjes së tyre sociale e ekonomike është edhe fakti se ata kishin ndërtuar një medrese dhe një shkollë për mësimin e leximit të Kur'anit (Daru'l-kurra)⁴¹ por, gjithashtu edhe shuma e madhe që lihej për mirëmbajtjen e saj. Kështu, në një dokument të përpiluar në prani të kadiut të qytetit të Beratit, Bektash Efendiut, zonja Aishe, e bija e Mahmut Pashës deklaronte se lë vakëf shumë e 100 mijë akçeve në favor të medresesë që kishte ndërtuar më herët së bashku me të shoqin.⁴² Sërish në lidhje me të njëjtën medrese kemi edhe një shënim tjetër, të përpiluar në të njëjtën ditë me atë më sipër, sipas të cilit Sali Beu, i biri i Hasan Pashës linte vakëf shumë e 80 mijë akçeve në favor të medresesë

³⁹ Shih *AQSH*, F. 128, D. 9, fl. 6.

⁴⁰ Për më shumë të dhëna shih *Osmanlı Dönemi Rumeli Para Vakıfları*, C. IV, Ed. Mehmet Bulut, Istanbul: Erkam Yay., 2019, f. 30-32.

⁴¹ Në një dokument tjetër të përpiluar sërish përpara kadiut, në vitin 1701 e njëjta zonjë, Aisheja linte në formën e vakëfit shumë e 75 000 akçeve, të holla të cilat do të përdroreshin për shpenzimet e Daru'l-kurrasë që përmendet. Shih *Rumeli Para Vakıfları...*, C. 4, f. 36-37.

⁴² *AQSH*, F. 128, D. 10, fl. 16; Ndryshe nga e shoqja e cila kishte lënë të holla për shpenzimet e këtyre objekteve arsimore si dhe administratorin e vakëfit, bashkëshorti i saj, Sali Beu kishte kontribuar me shumë e përmendur në tekst, që do të përdorej për medresenë e shkollën si dhe për rrogat e punëtorëve të cilët qenë të angazhuar në këto institucione. Shih *Rumeli Para Vakıfları...*, C. 4, f. 33-35.

që kishte ndërtuar me bashkëshorten e tij, zonjën Aishe.⁴³ Rasti i bashkëshortëve në fjalë dhe donacionit të tyre për institucionet arsimore të përmendura më sipër të tërheq vëmendjen për kapitalin dhe të ardhurat e mëdha që kishin familjet e shtresës drejtuese të qyteteve shqiptare gjatë kësaj kohe. Si Mehmet Beu ashtu edhe zonja Aishe qenë fëmijë pashallarësh, aspekt të cilin e vërejmë qartësisht prej faktit se pasuria e tyre vinte nga mylqe të shumta që kishin në hapësirën e Elbasanit, Beratit e Vlorës. Vetë fakti se ata dhuronin rreth 250 000 akçe për një medrese e Daru'l-kurra, një shumë tejet e madhe për kohën, nxjerr qartësisht në pah pasurinë e madhe që posedonte shtresa drejtuese në qytetet osmane.

Në lidhje me këtë medrese ekzistojnë edhe dokumente të tjera arkivore, të cilat na paraqesin aspekte të tjera të saj si institucion por edhe të personelit që punonte këtu. Për shembull, nga një dokument tjetër që daton në vitin 1717 mësojmë se myteveliu i medresesë në fjalë ishte Hasan Hoxha. Kështu, sipas shkresës së përpiluar prej administratorit të sipërpërmendur, vërtetohet se personi i quajtur Hysen Çelebiu i cili më herët kishte tërhequr hua nga vakëfi i medresesë shumë e 3950 akçeve, e kishte shlyer atë.⁴⁴ Një rast i ngjashëm është edhe ai i myteveliu të vakëfit të Ahmet Bej Uzgurit, i cili kishte hequr dorë së marri shumë e 2 akçeve që softabash Mustafai kishte tërhequr në formën e huasë prej institucionit.⁴⁵

Një aspekt që na tërheq vëmendjen është edhe fakti se prej vakëfit të medresesë kishte njerëz që tërhiqnin hua. Në këtë rast, huamarrësi mund të ishte individ i cili qe pjesë e personelit të shkollës dhe, në rastin kur përballej me ndonjë të papritur, e kishte të lehtë të tërhiqte para hua nga vakëfi i medresesë me kushtin që ta kthente më vonë. Një praktikë të cilin e hasim shumë shpesh veçanërisht te vakëfet e grupeve esnafore.

Duket se niveli i medreseve të Beratit ishte cilësor pasi mësojmë se për të studiuar këtu vinin nxënës edhe nga qytete e vende të tjera. I tillë ishte edhe rasti i Sejjid Fehmi Aliut nga Levkovci, i cili kishte ardhur në Berat pranë vëllait të tij që kryente detyrën e naibit dhe ishte regjistruar në medrese. Në mbishkrimin e varrit të tij që gjendet në varrezat pranë

⁴³ *AQSH*, F. 128, D. 16, fl. 58.

⁴⁴ Fjala "hoxhë" në këtë rast mund t'i referohet hoxhës në kontekstin e klerikut por edhe mësuesit ku, në këndvështrimin tonë, kjo e dyta është më e mundshme pasi në rolin e administratorit duket se është zgjedhur një mësues, i cili e njihnte edhe më mirë funksionimin e shkollës dhe të sistemit arsimor. *Shih po aty*, F. 128, D. 10, fl. 88.

⁴⁵ *Po aty*, F. 128, D. 16, fl. 1.

xhamisë Mbret, mësohet se i ndjeri ka ndërruar jetë në moshë të re, ndërsa vijonte mësimet në këtë medrese. Teksti që daton më 3 tetor 1850, përveç emrit të djaloshit, vëllait të tij dhe detyrës që ai ushtronte, gjithashtu na jep informacione edhe mbi medresenë ku, në shënim thuhet se djaloshi ishte i dhënë pas sarfit dhe nahivit (morfologjisë dhe sintaksës), dy lëndë që jepeshin mes shumë të tjerash në këtë institucion arsimor.⁴⁶

Berati qe një qendër e rëndësishme ekonomike gjatë shek. XVII-XVIII, aspekt i cili natyrshëm refleктоhej edhe në investimet dhe ngritjen e institucioneve të ndryshme. Në rastin konkret, të medreseve. Kështu, përveç objekteve të kësaj kategorie të qytetit, të cilat i paraqitëm më sipër, vërejmë se edhe në fshatrat që vareshin prej Beratit kemi prezencë të institucioneve të ngjashme. I tillë është shembulli i fshatit Perondi ku, banorët e fshatit janë mbledhur duke formuar një vakëf me kontribute të përbashkëta, të gjitha këto me qëllimin për të ndërtuar një medrese në këtë fshat.⁴⁷

Zhvillimi ekonomik e kulturor i qytetit, jeta e pasur kulturore dhe cilësia e lartë e mësimet që jepej në këto institucione, kishte bërë që në Berat të vërehet një aktivitet i gjerë në fushën e arsimit duke tërhequr edhe nxënës prej hapësirave të tjera përreth. Kjo klimë pozitive duket se ka qenë edhe shkak që medresetë e Beratit të kenë patur një frekuentim të madh deri në pragun e pavarësisë. Kështu, në vitin 1901 vërejmë që në qytet të ketë plot 162 nxënës medreseje, shifër të cilën nuk e hasim në qytetet e tjera të mëdha të Shqipërisë.⁴⁸

Ndërsa në Shkodër, e cila qe njëkohësisht edhe qendra e vilajetit, njëra prej medreseve gjendej në tregun e qytetit dhe që njihej ndryshe edhe si Medreseja e Pazarit.⁴⁹ Ippen shprehet se kjo shkollë përbëhej nga

⁴⁶ Për më shumë shih *AIH*, A-III-435, V.i Buharaja, “Mbishkrime të marra nga xhamitë në rrethet Krujë, Lezhë ...” f. 96.

⁴⁷ *AQSH*, F. 128, D. 18, fl. 30.

⁴⁸ Për detajet shih *Maarif Salnamesi...*, f. 935.

⁴⁹ Në anuarin osman të vitit 1312 H. në Shkodër përmenden dy medrese. Shih *İşkodra Vilayeti Salnamesi...*, Tab. 3, f. 68. Medreseja e Pazarit qe më e vonshme se ajo e Qafës dhe ishte ndërtuar si një godinë dykatëshe ku gjendeshin si dhomat në të cilat kryhej procesi mësimor apo ato të profesorëve, por edhe të tjera që shërbenin si hapësira ku flinin nxënësit e huaj, pra ata që nuk ishin nga Shkodra. Bushati shprehet se në këtë medrese kishin marrë mësim dijetarë e klerikë të mëdhenj të Shkodrës si Daut Boriçi, Hafiz Ali Ulqinaku, Jusuf Efendi Tabaku e të tjerë. Për më shumë të

dy ndërtesa kryesore, njëra e cila përdorej si medrese ndërsa tjetra i ishte rezervuar bibliotekës. Gjithashtu ai përmend edhe ekzistencën e disa kioskave, të cilat qenë lënë pas dore.⁵⁰ Siç duket, objektet në fjalë ishin pjesë e një kompleksi i cili, me shumë mundësi që ndërtuar qysh më herët porse biblioteka ishte përfunduar më vonë prej Kara Mahmud Pashës. Këtë e vërteton edhe fakti se në anuarin e *Maarif Nezareti* (Ministria e Arsimit) për vitin 1901, kjo medrese, e cila në këtë kohë kishte një numër prej 27 studentësh, theksohet se është ndërtuar prej Mustafa Sherif Pashës.⁵¹ Kjo panoramë na ngjan e zyrtë pasi në kohën kur e ka vizituar qytetin, Çelebiu shprehet se këtu gjendeshin plot shtatë institucione të tilla dhe secila xhami kryesore kishte ngjitur një objekt të tillë arsimor.⁵²

Sigurisht që medreseja e Pazarit që një institucion të cilin e gjejmë në funksionalitet deri vonë por, pavarësisht shifrës së dhënë prej Çelebiut, objekti më i vjetër i kësaj kategorie në Shkodër për të cilën kemi informacion, është ajo e Qafës, që ishte ndërtuar prej vetë Mehmed Pashë Plakut. E ngritur mbi majën e një kodre, kjo medrese që një ndërtesë dykatëshe me 11 dhoma të brendshme si dhe me një mesxhid. Në vakfijen e lënë nga pashai janë caktuar të ardhurat, pagesat e mësuesve si dhe shpenzimet që kishte objekti në fjalë. Siç duket, një pjesë e këtyre dhomave janë përdorur në formën e konviktit për nxënësit që vinin prej zonave të largëta, ndërsa ata të qytetit kanë shkuar e ardhur vetëm për procesin mësimor. Megjithëse me problematika në mirëmbajtjen e saj, ky institucion arsimor mësojmë ta ketë vijuar ekzistencën e vet deri në vitin 1925, ndërsa më 1939 ndërtesa është dëmtuar prej trupave italiane duke u bërë e papërdorshme.⁵³

Çelebiu na flet edhe për ekzistencën e dy medreseve në qytetin e Kavajës, informacion të cilin nuk e hasim te punimi i Ayverdi-t.⁵⁴ Të

dhëna në lidhje me medresenë e përmendur, shih H. Bushati, *Shkodra dhe motet...*, vëll. II, f. 91-92.

⁵⁰ Theodor Ippen, *Shqipëria e vjetër*, përktheu nga origjinali Gjerak Karaiskaj, Ardian Klosi, Tiranë: K&B, 2002, f. 127.

⁵¹ *Maarif Salnamesi...*, f. 352.

⁵² E. Çelebi, *Seyahatname...*, C. 6, f. 109; Në lidhje me kompleksin dhe bibliotekën në fjalë shih H. Bushati, *Shkodra dhe motet...*, vëll. I, f. 245.

⁵³ Për të dhëna më të detajueshme në lidhje me medresenë e Qafës shih H. Bushati, *Shkodra dhe motet...*, vëll. II, 87-91; Sërish sipas salnamesë së mësipërme, në vitin 1901 në këtë medrese studionin 43 nxënës. Shih *Maarif Salnamesi...*, f. 352.

⁵⁴ E. Çelebi, *Seyahatname...*, C. 8, f. 712; Ndërkohë që në fundin e shek. XIX në Kavajë vërejmë ekzistencën e vetëm një medreseje, e cila ishte ndërtuar prej Ibrahim Beut në

dhënat e Çelebiut janë me rëndësi sepse tregojnë që këto medrese datojnë në një periudhë më të hershme se gjysma e shek. XVII por edhe për faktin se, nisur nga mungesa e institucioneve administrative në Durrës, ndërtesat e të cilave gjendeshin në Kavajë, duket se edhe në aspektin arsimor qyteti bregdetar që i varur nga qendra urbane në fjalë. Siç duket, më vonë edhe në Durrës është hapur një medrese e tillë, e cila në vitin 1901 mësojmë të ketë 49 nxënës.⁵⁵

Kronikani i famshëm osman flet për ekzistencën e tri medreseve edhe në qytetin e Peqinit, një qendër urbane e rëndësishme përgjatë rrugëve të rëndësishme lidhëse të Shqipërisë së Mesme, e cila për nga parametrat demografikë dhe ato ekonomikë thuhet se në të njëjtin nivel me Kavajën.⁵⁶ Megjithatë, duhet theksuar se, pavarësisht faktit që këto institucione arsimore qenë ngritur prej bamirësve të ndryshëm sipas formatit të medreseve, faktorë të shumtë si demografia, aspekti gjeografik por edhe ai ekonomik qenë elementë të rëndësishëm të cilët përcaktonin edhe madhësinë dhe cilësinë e këtyre institucioneve. Pra, ndryshe që një medrese e ndërtuar në Peqin dhe krejtësisht një paraqitje, organizim e përmasa kishte një tjetër e ngritur në Berat, Elbasan a Gjirokastrë, qendra të vjetra urbane e administrative, me një ekonomi të konsoliduar si dhe me një kulturë të zhvilluar ku hasej një klasë dijetarësh të cilët jepnin mësim nëpër këto medrese.

Megjithëse nuk përmendet te studimi i Ayverdi-t, salnameja e Shkodrës vë në dukje ekzistencën e një medreseje në qytetin e Tiranës, rreth së cilës hasim informacione shumë më të detajuara në një dokument të përpiluar më 2 shkurt 1867. Dokumenti në fjalë flet për vakëfin e Sulejman Izzet Pashës, djalit të Kapllan Pashës, i cili duket se e kishte ngritur këtë institucion bamirësie së bashku me vëllezërit e tij. Bamirësit e përmendur, prej mylqeve dhe pronave të tjera që kishin në Tiranë patën ngritur një vakëf, ku shuma e parave të këtij institucioni shkonte në vlerën e 110 000 kurushëve. Një të tretën e shumës në fjalë, pra 36 666 kurushë ata i ndanin për shpenzimet e medresesë që kishin ndërtuar pranë xhamisë Atik si dhe për rrogat e punonjësve të këtij institucione e

pjesën e pazarit të qytetit dhe frekuentohej prej 29 studentësh. Për detajet shih *Maarif Salnamesi...*, f. 352.

⁵⁵ Sipas burimeve, ndërtuesi i medresesë në fjalë është Beshirzade Efendiu. Për më shumë shih *Maarif Salnamesi...*, f. 352.

⁵⁶ E. Çelebi, *Seyahatname...*, C. 8, f. 713.

shpenzime të tjera.⁵⁷ Ndërkohë që në anuarin e Maarif Nezaretit për vitin 1901 përmendet ekzistenca e tri medreseve në kazanë e Tiranës, në të cilat mësonin plot 162 nxënës.⁵⁸ Aty nuk përmenden emrat e themeluesve të këtyre medreseve përveç Abdurrahman Beut, i cili duhet të ketë ngritur një të njëjtën prej tyre.

Përfundim

Në përfundim mund të themi se, ashtu si në të gjithë Perandorinë Osmane, edhe në Shqipëri kemi një prani të medreseve gjatë periudhës së sundimit të osmanëve në këtë hapësirë. Këto institucione të rëndësishme arsimore, të cilat përfaqësonin edhe nivelin më të lartë të nxënies së dijës e shkencës në shtetin osman, i hasim në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë, ku, spikasin veçanërisht ato të Beratit, Gjirokastrës e Shkodrës, të cilat jo vetëm që kishin një kurrikul të pasur por, këtu vërejmë të kenë dhënë mësim personalitete të kohës që vinin prej anëve të ndryshme të perandorisë.

Mirëmbajtja dhe funksionimi i institucioneve arsimore në përgjithësi e të medreseve në veçanti, lidhej ngushtë edhe me aspektin ekonomik, prej të cilit varej edhe mbarëvajtja e aktivitetit të tyre. Pikërisht këtu ndërthuret edhe marrëdhënia e medreseve me një të njëjtën prej institucioneve kryesore ekonomike të shtetit osman, vakëfeve, të cilat qenë organizime të pavarura, të themeluara prej bamirësve të ndryshëm, që kontribuonin në të mirë të komunitetit. Në rastin konkret, ky kontribut jepej në fushën e arsimit. Siç u pa edhe më lart, thuajse deri në gjysmën e shek. XIX, ekzistenca dhe funksionimi i medreseve ka qenë tërësisht i varur nga kontributi i këtyre institucioneve të bamirësisë.

⁵⁷ Xhamia Atik nënkupton xhaminë e Vjetër, e cila përkon me atë të Sulejman Pashës. Ky duket se që vendi ku ishte ndërtuar objekti i përmendur. Shih *Rumeli Para Vakıfları...*, C. 4, f. 25-29.

⁵⁸ Për më shumë detaje në lidhje me këto të dhëna, shih *Maarif Salnamesi...*, f. 352.

*S u m m a r y***A GENERAL VIEW OF THE CONTRIBUTION OF WAFQS TO THE MADRASAH'S
IN ALBANIA DURING THE OTTOMAN RULE**

As the main educational institutions of the time, the Madrasah's were very spread in Albania as well as in the other parts of the Ottoman Empire. Thus, we can testify their presence in the most developed Albanian towns such Berat, Gjirokastra, Shkodra, Elbasan etc. where were taught many sciences by eminent professors. In these educational institutions we find students and teachers who came from different areas of the Balkans, an aspect which points out the quality and the high educational level of these institutions.

The maintenance of madrasah's and their operation in general was closely linked to the economic factors, which were very crucial in the functioning of them. This important aspect makes evident another important institution of Islamic and Ottoman history, waqf. Waqfs were pious endowments founded by people or groups and gave their contribution in several areas, including education. In this context, starting from the early days of the Ottoman Empire until the second half of XIXth century, all education institutions and the people who served here were financed by these philanthropic objects. This important aspect can be traced easily in the madrasah's which operated in several Albanian towns during the ottoman period.